



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KODIFIKIMIT DHE HARMONIZIMIT
TË LEGJISLACIONIT

Nr. 5102/prot.

Tiranë, më 29.09.2023

Lënda: Kthim përgjigje shkresës tuaj mbi vënien në dispozicion të urdhrin të grupit të punës për hartimin e Kodit të ri Penal

INSTITUTIT SHQIPTAR TË SHKENCAVE
Rruga "Asim Vokshi", Pallati 13/25, kati i 3-të ✓

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj të datës 21.08.2023 nëpërmjet së cilës kërkon: i) vënien në dispozicion të urdhrin të Ministrit të Drejtësisë për ngritjen e grupit të punës për hartimin e kodit të ri penal, ii) dokumentet shoqërues, iii) dokumentet që konsultohen dhe përgatiten, si dhe iv) datat e mbledhjeve që organizohen:

Lutemi gjeni bashkëlidhur kësaj shkrese urdhrin nr. 150, datë 06.02.2023 të Ministri të Drejtësisë "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Kodit të ri Penal". Në këtë urdhër gjenden edhe anëtarët e grupit të punës. Ky urdhër nuk ka dokumente shoqëruese.

Lidhur me kërkesën për vënien në dispozicion të dokumenteve që konsultohen dhe përgatiten, ju bëjmë me dije se në faqen e internetit të Ministrisë së Drejtësisë në datë 25 korrik është publikuar pjesa e përgjithshme e draftit të Kodit Penal¹, në seksionin e prioritetëve. Gjithashtu, lidhur me këtë proces është paraqitur edhe thirrja për përcjelljen e punimeve shkencore në fushën e të drejtës penale materiale, me synimin që të garantohet harmonizimi i legjislacionit penal, si dhe përputhshmëria me *acquis* e BE-së dhe me standardet ndërkombëtare në fushën penale.

Ndërkohë, pjesa e posaçme e draftit nuk është publikuar pasi është ende në hartim nga grupi i punës, pasi janë kërkuar mendimet edhe nga institucionet e pavarura të sistemit drejtësisë si dhe organizatat ndërkombëtare.

Në këto kushte, drafti është ende në fazë hartimi, nga grupi i punës, dhe si i tillë nuk ka një variant i cili mund të vendoset në dispozicion të publikut të gjerë, qoftë edhe nëpërmjet plotësimit të një kërkesë për informacion e si rrjedhim konsiderohet një dokument pune jo përfundimtar.

Pas përfundimit të hartimit të këtij drafti nga grupi i punës, Ministria e Drejtësisë do të fillojë procedurat për konsultimin e tij publik, në përputhje me ligjin nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe

¹<https://e-aktet.gov.al/institucionet/drejtesia21/MaterialDetails.aspx?Id=9c3959f6-76cc-4c34-a8db-2bc30a12e06e&OpinionId=52d2733f-5a7c-4c0c-be62-0fdfb4a5fbd2&VersionId=a62f65bc-6332-4ebe-8dbc-025d2c607f7e##opinionsPageView>

onsultimin publik". Nëpërmjet këtij procesi synohet të merret inputi nga institucionet shtetërore, institucionet e pavarura, shoqëria civile, bota akademike, por edhe nga qytetarët me qëllim garantimin e një procesi gjithëpërfshirës. Çdo kontribut i dhënë mbi këtë nismë ka një rëndësi të veçantë, për arritjen e qëllimit për hartimin e një Kodi Penal modern, që përmban dhe mbron vlerat më të larta shoqërore.

Për sa më sipër, duke ju falënderuar për shprehjen e interesit tuaj në këtë proces, ju bëjmë me dije se kërkesa tuaj do të mbahet në konsideratë për njoftimin në tryezat konsultative që do të zhvillohen përgjatë konsultimit publik të kësaj nisme.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Ismail Shehu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 866 Prot.

Tiranë, më ^{06.02} 1 / 2023

U R D H Ë R

NR. 150, DATË 06.02.2023

“PËR NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR HARTIMIN E KODIT PENAL”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 6, pika 2 dhe nenit 7, pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar,

Duke pasur parasysh që nga viti 1995 në të cilin është miratuar, deri më sot, Kodi Penal ka pësuar ndryshime nëpërmjet 24 ligjeve të ndryshme, ndërsa Gjykata Kushtetuese, ka dhënë 9 vendime, ku ndër të tjera ka shfuqizuar dispozita të caktuara të këtij Kodi. Të gjitha këto ndryshime vlerësohen se kanë prekur mbi 70% të dispozitave të Kodi Penal, duke sjellë nevojën për vlerësimin e harmonizimit të brendshëm të dispozitave të këtij kodi;

Duke vlerësuar që prokurorë, gjyqtarë, avokatë, pedagogë të së drejtës penale, si dhe nga organizata të shoqërisë civile kanë venë në dukje nevoja për një Kod të ri Penal, që të harmonizojë strukturën dhe dispozitat aktuale, duke i përafuar njëkohësisht ato me standardet ndërkombëtare dhe politikën penale bashkëkohore;

Duke pasur në konsideratë nevojën urgjente për një rishikim tërësor të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, si në pjesën e përgjithshme edhe në pjesën e posaçme të tij;

Duke vlerësuar se, për realizimin e këtij objekti është e nevojshme ngritja e një grupi të posaçëm pune të përbërë nga profesionistë të fushës dhe studiues të së drejtës dhe doktrinës penale që të vlerësojë përmbajtjen si dhe hartojë parimet dhe kriteret bazë për ndërmarrjen e nismës ligjore,

U R D H Ë R O J:

- 1) Ngritjen e grupit të punës për hartimin e Kodit Penal.

2) Grupi i punës kryesohet nga Drejtori i Shkollës së Magjistraturës, z. Arben Rakipi, Drejtor i Shkollës së Magjistraturës, dhe ka në përbërje:

a) z. Bledar Mustafaraj, Përgjegjës i Sektorit të së Drejtës Penale, Drejtorja e së Drejtës Penale dhe Civile dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit (Magjistrat i Komanduar);

b) z. Sokol Binaj, gjyqtar në Gjykatën e Lartë;

c) z. Gentian Jahjollli, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër;

ç) znj. Dorina Hoxha, dekane e Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës;

d) z. Skëndër Kaçupi, pedagog pranë Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës.

3) Grupi i punës ka për detyrë:

a) vlerësimin dhe rishikimin e draftit të hartuar të Kodit të ri Penal me qëllim:

i. hartimin e një akti ligjor gjithëpërfshirës dhe aktual në përputhje me praktikat më të mira dhe standardet ndërkombëtare;

ii. vlerësimin e përputhshmërisë dhe përqasjes së legjislacionit shqiptar në fushën penale me të drejtën e Bashkimit Evropian dhe të drejtën ndërkombëtare penale duke përfshirë Konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar;

iii. reflektimin e përfundimeve të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë, Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian, Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;

b) hartimin e dokumenteve shoqëruese mbi argumentimin e ndërhyrjeve dhe parashikimeve të draftit të Kodit Penal;

c) propozimin Ministrit të Drejtësisë të Kodit të ri Penal të rishikuar në tërësi, e hartuar me kontributin dhe mbështetjen e drejtorisë së përgjithshme të kodifikimit, si dhe ekspertëve të tjerë vendas dhe ndërkombëtarë.

4) Grupi i punës në përmbushjen e detyrave të tij, mbështetet nga grupi i ekspertëve të oponencës së draftit të Kodit Penal, i cili ka në përbërje:

a) znj. Tereza Merkaj, gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit;

b) znj. Nurieta Tafa, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës;

c) z. Erjon Bani, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit;

ç) z. Ylli Pjetërnikaj, prokuror pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë;

d) z. Kujtim Luli, prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme;

5) Grupi i punës së ekspertëve të oponencës ka për detyrë:

a) ofrimin e mendimit të specializuar mbi përmbajtjen e draftit të hartuar të nga grupi i punës për hartimin e Kodit të ri Penal;

b) paraqitjen e rekomandimeve apo komenteve lidhur me përmbajtjen e draftit të Kodit Penal në kuadër të garantimit të përputhshmërisë dhe përqasjes së legjislacionit shqiptar në fushën penale me të drejtën e Bashkimit Evropian dhe të drejtën ndërkombëtare penale, duke përfshirë Konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar;

c) bashkërendimin e punës me grupin e punës për hartimin e Kodit të ri Penal dhe unifikimin e draftit përfundimtar të Kodit;

6) Në takimet me grupin e ekspertëve të oponencës, në varësi të nevojave të vlerësuara nga grupi i punës për hartimin e Kodit Penal, mund të thirren edhe ekspertë të organizatave ndërkombëtare.

7) Në mbledhjen e tij të parë, grupi i punës miraton metodologjinë mbi zhvillimin e mbledhjeve si dhe hapat që do të ndiqen deri në përfundim të procesit për hartimin e Kodit Penal.

8) Për përgatitjen e materialeve dhe mbështetjen e veprimtarisë së grupit të punës ngrihet dhe funksionon sekretariati teknik. Sekretariati teknik është i përbërë nga:

a) Kristina Puci, Koordinatore në Sektorin e së Drejtës Penale, Drejtorja e së Drejtës Penale dhe Civile dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit;

b) Klobeta Zylyfi, Kandidate për magjistrate;

c) Ketjona Kaçupi, Kandidate për magjistrate.

9) Sekretariati teknik ka për të detyrë:

a) përgatitjen e materialeve për mbledhjet e grupeve të punës;

b) mbajtjen e procesverbalit të mbledhjeve të zhvilluara nga grupi i punës;

c) kryerjen e detyrave të tjera administrative të ngarkuara nga kryetari i grupit të punës.

10) Drafti i Kodit Penal dhe dokumenteve shoqërues, objekt i veprimtarisë së grupit të punës sipas përcaktimit të shkronjës të pikës 3 të këtij urdhri, hartohet dhe i dorëzohet Ministrit të Drejtësisë brenda datës 31 korrik 2023.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Ulsi Marja

